

Në bazë të nenit 93 paragrafi (6) i Ligjit të Energjetikës* ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19), Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 19 nëntor 2020, solli

A K T V E N D I M

për miratimin e kërkesës për ndryshimin e kategorisë së kyçjes

1. Miratohet kërkesa e SHPKNJP Elektrodistribucija Shkup nr. 12-2313/1 datë 16 nëntor 2020 për ndryshimin e kategorisë së kyçjes të konsumatorit Shoqëria e Prodhimit, e Shërbimeve dhe e Tregtisë KALA SHPK Shkup, me numër tatimor 4030991181114 edhe atë:
 - vendi i shpenzimit nr. 104216911000,
 - adresa e vendit matës: rr. Voin Drashkoci, Shkup,
 - kategoria ekzistuese e kyçjes: LV2;
 - kategoria e re e kyçjes: LV1.2;
 - niveli i tensionit të matjes: tension i ulët dhe
 - lokacioni i matjes: tension i ulët dhe dalje e veçantë deri te TS.
2. Obligohet SHPKNJP Elektrodistribucija Shkup ta përditësojë listën nga neni 93 paragrafi (3) pika 5) të Ligjit të Energjetikës* për ndryshimin e kategorisë së kyçjes nga LV2 në LV1.2 të konsumatorit Shoqëria e Prodhimit, e Shërbimeve dhe e Tregtisë KALA SHPK Shkup dhe posaçërisht ta theksojë arsyen për ndryshimin e kategorisë së kyçjes.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

A r s y e t i m

SHPKNJP Elektrodistribucija Shkup, në bazë të nenit 93 paragrafi (6) të Ligjit të Energjetikës*, ka dërguar deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut kërkesë për miratim të ndryshimit të kategorisë së kyçjes nr. 12-2313/1 datë 16 nëntor 2020.

Kërkesa i referohet ndryshimit të kategorisë së kyçjes nga LV2 në LV1.2 të konsumatorit Shoqëria e Prodhimit e Shërbimeve dhe e Tregtisë KALA SHPK Shkup, vendi i shpenzimit nr. 104216911000 dhe adresa e vendit matës rr. Voin Drashkoci, Shkup.

Kërkesa është dorëzuar si rezultat i dislokimit të planifikuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në pajisjen matëse deri te TS, i cili momentalisht është i vendosur në objektin e përdoruesit, në dalje të veçantë të destinuar vetëm për përdoruesin. Duke pasur parasysh se në evidencën aktuale të Elektrodistribucija SHPKNJP Shkup, ky vend matës ka kategori të kyçjes LV2, është kërkuar që të bëhet korigjim i kategorisë së kyçjes në LV1.2. Për këtë shkak, është e nevojshme të ndryshohet kategoria e kyçjes për këtë vend matës nga LV2 në LV1.2. Në shtojcë të kërkesës, Elektrodistribucija SHPKNJP Shkup ka dërguar fotografi nga vendi matës, SGJI skicë dhe informatë se vendi matës nuk është në procedurë të ndërrimit të furnizuesit.

Duke pasur parasysh të lartpërmendurën si dhe nenin 4 paragrafi (2) pika 4 të Sistemit Tarifor të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për Konsumatorët e Kyçur në Sistemin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të SHPKNJP Elektrodistribucija Shkup ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 95/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 271/20), në përputhje me të cilin në kategorinë LV1.2 bëjnë pjesë kyçje me tension të ulët, përmes të

cilave energjia elektrike mirret direkt nga mbledhës me tension të ulët në stacionet e transformatorit me tension të mesëm/ tensionit të ulët, gjatë së cilës matja e energjisë elektrike të dorëzuar mund të bëhet edhe në ndërtesën e konsumatorit nëse në dalje nuk është kyçur edhe ndonjë konsumator tjetër, Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Ky aktvendim hyn në fuqi me ditën e miratimit të tij, ndërsa publikohet në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ngritet kontest administrativ në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes.

PA1, nr. 12-2313/2

19 nëntor 2020

Shkup

**Kryetari i Komisionit Rregullator të Energjetikës
dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së
Maqedonisë së Veriut**

Марко Бислимоски